

RAPORT I AUDITIT TE PAVARUR

Per krijimin e te ardhurave dhe shpenzimet te kryera nga partia e Minoritetit
Etnik Grek per te Ardhmen (MEGA) per Vitin 2011

Drejtuar Komisionit Qendror te Zgjedhjeve
Tirane

Zoterinje te nderuar !

Ne ekzekutim te misionit qe me eshte besuar prej jush , kam nderin t`ju paraqes raportin mbi pasqyrimin e te ardhurave dhe shpenzimeve te Partise se Minoritetit Etnik Grek per te Ardhmen (MEGA) per vitin 2011.

PERGJEGJESIT RESPEKTIVE

Pergjegjesia per perгатitjen e deklarimit pasqyres financiare eshte e drejtimit te Partise , te cilet mbajne pergjegjesite e plota per saktesine e tyre. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendeshem te pershtatshem mbi perгатitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare pa anomali, zgjedhjen dhe zbatimin e metodave te pershtatshme kontabel.

PERGJEGJESIA E AUDITUESIT

Eshte pergjegjesia ime si audit i pavarur te shpreh nje opinion te arsyeshem mbi keto pasqyra, duke u mbeshtetur ne Standartet Nderkombetare te Auditimit, ne normat dhe kerkesat e profesionit, kerkesat e vecanta qe ka Kodi Zgjedhor i Shqiperise, ligji per partite politike dhe udhezime te ndryshme te KQZ-se, per te marre nje siguri te arsyeshme nese pasqyrat nuk kane anomali materiale , si dhe ne zbatimin e ligjit 9228, "Per Kontabilitetin " dhe SKK-ve perkatese dhe ta raportoj ate para jush.

Auditimi ka perfshire kryerjen e procedurave per te marre evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga audituesi, perfshire ketu edhe vlersimin mbi gjykimet dhe metodat e perdorura nga ana e Partise ne perгатitjen e ketyre pasqyrave, ne perputhje me vecorite specifike te saj. Gjithashtu jane mbajtur parasysht dhe kerkesat e vendimit nr 3 date 18.01.2012 te KQZ-se per strukturen e raportit te auditimit.

Auditimi eshte mbeshtetur mbi informacionet dhe shpjegimet e vena ne dispozicion pa asnje rezerve nga ana e Partise, ne testimet e kryera, te konsideruara te mjaftushme per mbeshtetjen e opinionit mbi keto pasqyra, te cilat i sherbejne nje qellimi specifik.

Ne formimin e opinionit te auditit u vleresua gjithashtu dhe saktesia e prezantimit te informacionit.

Opinionimi im u mbeshtet edhe ne faktin se drejtimi i Partise nuk kishte njohuri te plota per ligjin, per evidentimin e kontributeve, detyrimet ligjore, pasojat qe sjell moszbatimi korrekt i ligjit dhe pergjegjesite e tyre personale.

Kryetari i Partise MEGA z. Kristaq Kiço beri deklarim me shkrim se nuk kishte perfituar kontribute dhe donacione per partine e tij gjate vitit 2011 nga buxheti i shtetit.



Une cmoje se auditimi i kryer perben nje baze te arsyeshme per te shprehur opinionin tim te pavarur.

OPINIONI

Bazuar ne auditimin e kryer, me siguri te arsyeshme , sipas opinionit tim si audit, pasqyrat financiare per te ardhurat dhe shpenzimet e Partise se Minoritetit Etnik Grek per te Ardhmen (MEGA), per vitin 2011 perfshire dhe fushaten per Zgjedhjet Vendore te Pushtetit Lokal te Shqiperise,te dates 8 Maj te vitit 2011, nuk jane te ndertuara plotesisht sipas kerkesave te ligjit. Per keto arsye opinionimi im si auditues eshte me rezerve (i cilesuar) per keto pasqyra financiare.

Tirane me 18.06.2012

Audit i Pavarur
Qani Kajo



Adresa: Rruga "Myslym Shyri" Pall. 49/1/3
Tel. 04 2244974 Mob.0692070915
Lic. prof. Nr. 76; Nipt K37810309H